



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 218, Datë 16.10.2024**

**MBI**

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “REBESOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 dhe në mbledhjen vijuese datë 16.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1855/5 prot., prot., datë 10.10.2024, dhe relacionin shtesë nr. 1855/6, datë 16.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “REBESOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855 prot., datë 02.09.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 12.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.09.2024 dhe 14.09.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1855/3 prot., datë 30.09.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet nga ky aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 11.10.2024, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, ku nga shqyrtimi paraprak i tij rezulton se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për të analizuar sa përcjellë nga shoqëria e për të zhvilluar më tej korrespondencën përkatëse me të, në lidhje me sa mbetet ende pa plotësuar për këtë aplikim, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të përcjellë informacionin/dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “REBESOL” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**